

Punëtorët me shërbim në sektorin e ndërtimit

Mësoni të drejtat
dhe detyrimet tuaja



- A punoni normalisht në një shtet anëtar të BE-së ndryshe nga ai ku jeni punësuar?
- A jeni duke u dërguar në një shtet tjetër anëtar nga punëdhënësi juaj për një periudhë të kufizuar kohore?
- Pasi të përfundojë detyra juaj, a planifikoni të ktheheni në shtetin anëtar ku është i bazuar punëdhënësi juaj?

Nëse u jeni përgjigjur **po** këtyre pyetjeve, ju ndoshta jeni një **punonjës me shërbim**.

Nëse jeni **punonjës me shërbim**, ju keni të drejta specifike.

Kushtet e përgjithshme të mëposhtme të punësimit të shtetit anëtar pritës zbatohen për punonjësit me shërbim:

- shpërblimi, duke përfshirë tarifatat jashtë orarit;
- orët maksimale të punës dhe periudhat minimale të pushimit;
- pushimi vjetor minimal i paguar;
- shëndeti, siguria dhe higjiena në punë;
- kushtet për punësimin e punonjësve, (p.sh. punësimi i personelit të përkohshëm përmes agjencive);
- kushtet për gratë shtatzëna, gratë që kanë lindur së fundi, fëmijët dhe të rinjtë (nën 18 vjeç);
- trajtimi i barabartë i burrave dhe grave dhe rregulla të tjera që parandalojnë diskriminimin;
- kushtet e akomodimit, nëse ofrohen nga punëdhënësi juaj;
- kompensimet dhe rimbursimet e shpenzimeve për të mbuluar shpenzimet e udhëtimit, ngrënies dhe akomodimit në shtetin anëtar pritës. Kjo zbatohet nëse ju kërkohet të udhëtoni gjatë detyrës ose të udhëtoni drejt dhe nga vendi juaj i rregullt i punës në shtetin anëtar pritës dhe nëse ky është trajtimi i rregullt për punonjësit në shtetin anëtar pritës.

Kushtet e shtetit anëtar pritës **zbatohen vetëm nëse ato janë më të favorshme se ato të shtetit tuaj anëtar të origjinës.**

Si punonjës me shërbim, ja se çfarë **DUHET TË BËNI JU:**

- Merrni “dokumentin portativ A1” (PD A1): punëdhënësi juaj duhet të aplikojë për dokumentin PD A1 në emrin tuaj nga institucioni i sigurimeve shoqërore në shtetin anëtar të origjinës. Dokumenti PD A1 vërteton se ju mbeteni i mbuluar nga sistemi i sigurimeve shoqërore në shtetin tuaj anëtar të origjinës.
- Nëse shërbimi juaj zgjat më shumë se 3 muaj, ju duhet të regjistroni vendbanimin tuaj pranë autoriteteve të shtetit anëtar pritës. Koha e kaluar me shërbim nuk do të sjellë të drejtën e qëndrimit të përhershëm. Mund të zbatohen rregulla të ndryshme për shtetasit e vendeve të treta.
- Informohuni në lidhje me marrëveshjet kolektive: në varësi të shtetit tuaj anëtar pritës dhe shtetit anëtar të punëdhënësit tuaj, ju mund të keni të drejtë të përfitoni të drejta përmes marrëveshjeve kolektive.

Si punonjës me shërbim, ja se çfarë **NUK** duhet të bëni:

- Nëse jeni shtetas i BE-së, Zonës Ekonomike Evropiane (nga Islanda, Lihtenshtajni dhe Norvegjia) ose Zvicra, nuk keni nevojë për leje pune.
- Ju nuk keni nevojë të njiheni me kualifikimet tuaja profesionale. Megjithatë, mund t’ju duhet të bëni një deklaratë me shkrim për disa aftësi profesionale, për shembull për të përdorur vinça, ashensorë speciale ose makineri shpimi.
- Ju nuk keni nevojë të regjistroheni pranë autoriteteve të sigurimeve shoqërore në shtetin anëtar pritës. Ju vazhdoni të jeni i siguruar në shtetin tuaj anëtar të origjinës. Gjatë shërbimit tuaj, ju nuk përfitoni asnjë të drejtë shtesë për sigurime shoqërore, të tilla si të drejtat e pensionit ose e drejta për përfitime papunësie në shtetin tuaj anëtar pritës.

Nëse jeni shtetas i një vendi të tretë, përpara se të dërgoheni me shërbim, juve ju duhet një leje pune për shtetin anëtar ku e ka bazën punëdhënësi juaj. Më pas, të njëjtat kushte zbatohen për ju si për punonjësit e tjerë të dërguar me shërbim që janë shtetas të BE-së.

Çfarë duhet bërë **në rast problemi?**

Në rast se nuk e keni marrë rrogën ose jeni paguar më pak, ju mund që:

- Të përpiqeni ta zgjidhni çështjen, si me punëdhënësin tuaj në shtetin tuaj anëtar, ashtu edhe me kontraktorin në shtetin tuaj anëtar pritës, pasi të dy mund të mbahen përgjegjës për respektimin e këtyre detyrimeve.
- Të kontaktoni me inspektoratin e punës të shtetit tuaj anëtar pritës ose të origjinës dhe të bëni një ankesë ose të filloni procedurat gjyqësore. Kjo mund të bëhet edhe pas përfundimit të shërbimit tuaj dhe nga shteti anëtar i origjinës.

Për më shumë informacion vizitoni faqen e internetit “Your Europe” dhe për ndihmë, konsultohuni me listën e administratave kombëtare të disponueshme atje.

<https://europa.eu!/pbjb3x>



Shteti anëtar pritës:

Vendi ku po kryeni punën tuaj.
Ky është i ndryshëm nga:

Shteti anëtar i origjinës:

Vendi ku normalisht punoni dhe
ku është i themeluar punëdhënësi juaj.



Puna afatgjatë me shërbim:

Nëse jeni me shërbim për më shumë se 12 muaj, zbatohen pothuajse të gjitha kushtet e përgjithshme të shtetit anëtar pritës. Megjithatë, punëdhënësi juaj mund të lëshojë një njoftim për të zgjatur kohëzgjatjen e shërbimit tuaj me afat të rregullt nga 12 në 18 muaj, duke ruajtur të njëjtat kushte të përgjithshme të punësimit. Kjo zgjatje është sipas gjyqimit të autoriteteve kompetente.

Shëndeti dhe siguria në punë:

Ju duhet të trajnoheni dhe të informoheni për rreziqet e sigurisë dhe shëndetit në punë në një gjuhë që e kuptoni. Gjithashtu duhet të pajiseni me pajisje të përshtatshme të mbrojtjes personale etj.

Për më shumë informacion
vizitoni faqen e internetit të
EU-OSHA





European Labour Authority

Landererova 12,
811 09 Bratislava,
Slovakia



info@**ela**.europa.eu



www.**ela**.europa.eu



https://www.facebook.com/
europeanlabourauthority



@**EU_ELA**



https://www.linkedin.com/company/
european-labour-authority



EURES



eures.ec.europa.eu



facebook.com/**EURESjobs**



@**EURESjob**



youtube.com/user/**EURESjob**



linkedin.com/company/**eures**



instagram.com/**euresjobs**

SQ

Luxembourg: Publications Office of the European Union, 2023

© European Labour Authority, 2023

Images: Cover, © Siberian Art/stock.adobe.com; © Boyko.Pictures/stock.adobe.com

Print: ISBN 978-92-9401-478-8 | doi:10.2883/13825 | HP-05-23-046-SQ-C

PDF: ISBN 978-92-9401-490-0 | doi:10.2883/5853 | HP-05-23-046-SQ-N



Publications Office
of the European Union